

Seminari IV ndërkombëtar «Shkodra në shekuj»

Muzeu Historik i Shkodrës dhe Universiteti «Luigj Gurakuqi» i Shkodrës organizuan seminarin ndërkombëtar, të katërtin me radhë, *Shkodra në shekuj*, prej 20 deri më 22 nëntor 2000, në Shkodër. Në 13 seksionet e këtij seminari ndërkombëtar morën pjesë me kumtesa mbi 200 studiues nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Italia, Turqia dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në Seksionin e Folklorit morën pjesë edhe katër studiues të IAP-it: dr. Sadri Feti, me temën *Shkodra dhe fillet e baladës së murimit*; dr. Zymer Neziri, me temën *Shkodra në motërzimin e këngës Shaqir Grisha të Maksimilian Lambercit*; dr. Adem Zejnullahu, me temën *Mendjemprehtësia shkodrane në krijimtarinë gojore*; dr. Rustem Berisha, me temën *Kënga Fryni era e u çel taraba. Përhapja e saj në trevën e Llapit*. Në këtë seksion ishin me interes edhe kumtesat e studiuesve nga Tirana, Shkodra e Puka: prof. Ramadan Sokoli, Persida Alla, prof. dr. Agron Xhagolli, Nexhmi Bushati, prof. dr. Ramazan Bogdani, dr. Selami Tabaku, Xhemal Meçi, prof. as. dr. Alfred Çapaliku, Isa Alibali etj..

Në Seksionin e Etnologjisë morën pjesë me kumtesa po ashtu edhe studiuesit e IAP-it: dr. Ukë Xhemaj, *Shkodra-Kosova, aspekte etnokulturore*; dr. Drita Statovci, *Veshja popullore në zhvillimet e së tashmes*; mr. Myzafere Mustafa, *Elemente mitologjike në Përralla Kombëtare të Donat Kurtit*; Leontina Gega-Musa, *Paralele të dasmës ndëmyjet dy malësive*; Arbnora Dushi, *Antonia Young dhe interesimi i saj për traditën shqiptare*. Në këtë seksion lexuan kumtesa me interes edhe dr. Antonio Belusci (Kozencë, Itali), dr. Antonia Young (Bradford, Britani e Madhe), si dhe studiues nga Instituti i Kulturës Popullore të Tiranës dhe nga Podgorica, Ulqini, Kërçova, Peja, Nju -Jorku, Shkupi e Shkodra, si: as prof. Afërdita Onuzi, dr. Agim Bido, as. prof. dr. Yllka Selimi, prof. Zija Shkodra, dr. Fatbardha Shkupi, dr. Anton K. Berisha, Asllan Bisha, Ibrahim Berjashi, prof. dr. Qemal Murati, prof. dr. Mark Tirta, Bashkim Lajçi, Idriz Lamaj, Ruzhdi Mata, dr. Zeqirja Neziri, prof. dr. Ali Muka, Ndriçim Mlika etj..

Nga IAP-i, në seksionet e tjerat të këtij seminari ndërkombëtar, morën pjesë me kumtesa edhe: mr. Lulëzim Lajçi, dr. Ragip Mulaku, dr. Muhamet Pirraku, dr. Shkëlzen Raça, dr. Zekeria Cana, dr. Xheladin

Shala, mr. Lush Culaj, dr. Rexhep Doçi, mr. Begzad Baliu, mr. Mehmet Halimi, mr. Arben Hoxha dhe dr. Emin Kabashi.

Përveç këtyre 19 studiuesve të IAP-it, në seminarin *Shkodra në shekuj* kanë marrë pjesë me kumtesa edhe studiues të tjerë nga fakultetet dhe nga institucionet e tjera shkencore dhe kulturore të Prishtinës e të Kosovës: mr. Nehat Krasniqi, Hasan Gjonbalaj, dr. Tefik Basha, dr. Gazmend Riza, mr. Riza Sadiku, dr. Nuhi Veselaj, Jetish Kadishani, dr. Sabile Keçmezi-Basha, Bashkim Lajçi, dr. Enver Mehmeti, dr. Latif Mulaku, dr. Shefki Sejdiu, dr. Abdullah Zymberi, mr. Hatixhe Hoxha, mr. Sala Ahmeti, mr. Iliaz Rexha, dr. Ruzhdi Ushaku etj..

Përveç rezultateve të rëndësishme të këtij tubimi të madh shkencor, të organizuar me shumë sukses nga Muzeu Historik i Shkodrës dhe nga Univesiteti «Luigj Gurakuqi», mikpritja e pashoqe shkodrane është kaptinë e veçantë e seminarit IV ndëkombëtar *Shkodra në shekuj*, që i lë të hapura të gjitha shtigjet e bashkëpunimit të Prishtinës me Shkodrën.

Zymer NEZIRI

Konferencë shkencore për mbijetesën etnokulturore të Kosovës

Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Institutit i Kulturës Popullore i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë organizuan konferencën shkencore «Mbijetesa etnokulturore e Kosovës e shpërngulur me dhunë, më 1998-1999». Konferenca u mbajt në Prishtinë, në Institutin Albanologjik, më 15 e 16 dhjetor 2000. Bartëse e organizimit ishte Dega e Folklorit e IAP-it. Në konferencë morën pjesë me kumtesa 47 studiues nga të dy institutet dhe studiues të tjerë nga Tirana, Prishtina, Ulqini, Tetova, etj. Kumtesat u lexuan në Seksionin e Folklorit dhe të Etnologjisë, si dhe në Seksionin e Gjuhës dhe të Historisë.

Ky ishte projekt i përbashkët i të dy instituteve. Ideator i projektit është dr. Agim Bido, IKP Tiranë.

Fjalën e hapjes e mbajtën drejtorët e këtyre dy institutive, as. prof. Afërdita Onuzi dhe dr. Sadri Fetiu.